



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 310 Prot.

Tiranë, më 14 . 01 . 2020

**U R D H Ë R**

Nr. 8 , datë 14 . 01 . 2020

**P Ë R**

**PROCESIN ZGJEDHOR PËR AUTORITETET DHE ORGANET  
DREJTUESE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 131 të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

**U R D H Ë R O J:**

1. Fillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë, në datën 9.4.2020.
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë, të jetë data 8.5.2020.
3. Institucionet publike të arsimit të lartë të marrin masat që të miratojnë rregulloren e zgjedhjeve, 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara datës së fillimit të procesit zgjedhor, të cilat duhet të depozitohen pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
4. Kandidatët për autoritete drejtuese dhe kandidatët për anëtarë të organeve drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë, me qëllim garantimin e integritetit të lartë, përpara aplikimit duhet të kenë marrë vlerësim pozitiv nga Këshilli i Etikës, i cili verifikon ligjshmërinë e fitimit të gradës shkencore dhe titullit akademik, përfshirë kontrollin antiplagjiaturë. Kriteri i vlerësimit të kandidatëve nga Këshilli i Etikës dhe procedurat, të përcaktohen në rregulloret përkatëse të zgjedhjeve të IAL-ve.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Besa SHAHINI**

